



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05
Prokurori kundër Salih Mustafës

Për: Gjykatësin e Vetëm
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtrues: Prokurori i Specializuar

Data: 5 tetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i redaktuar publik i

parashtrimeve të Prokurorisë për konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të z. Mustafa

Julius von Bone

I. HYRJE

1. Sipas Urdhrit për mbajtjen e konferencës mbi ecurinë e çështjes,¹ Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') paraqet parashtrimet e saj me shkrim për pikat e rendit të ditës të identifikuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,² dhe për çështjet e lidhura me to.³

2. Disa nga informacionet e dhëna janë detyrimisht të përkohshme në këtë fazë. Megjithatë, ZPS-ja parashikon se do të jetë në gjendje të ofrojë listat e plota të dëshmitarëve dhe të provave materiale dhe se do të ketë përmbushur detyrimin e nxjerrjes së materialeve sipas rregullës 102(1)(b)⁴ deri më 1 dhjetor 2020, në varësi vetëm të çfarëdo mase mbrojtëse në fuqi.

II. PARASHTRIMET

1. Tema të përgjithshme

3. Në këtë çështje gjyqësore janë ende duke u kryer një numër i vogël veprimesh hetimore. Në varësi të rezultatit të këtyre hetimeve të kufizuara, ekziston gjasa që të paraqiten prova të tjera. Megjithatë, ZPS-ja nuk parashikon që kjo të ndikojë në zhvillimin e shpejtë të procesit, pasi veprimet e mbetura hetimore ka të ngjarë të përmbyllen gjatë fazës së procedurës paraprake.

4. Për Aktakuzën e Konfirmuar ZPS-ja u mbështet te pesë (5) dëshmitarë dhe synon të mbështetet përsëri tek ta në gjykim. Aktualisht, ZPS-ja parashikon të shtojë të paktën edhe njëmbëdhjetë (11) dëshmitarë të tjerë në listën e saj të dëshmitarëve për

¹ Urdhër për caktimin e datës së konferencës mbi ecurinë e çështjes, KSC-BC-2020-05/F00023, 30 shtator 2020, Publik ('Urdhri për konferencën mbi ecurinë e çështjes').

² Shtojca 1 e Urdhrit për caktimin e datës së konferencës mbi ecurinë e çështjes, KSC-BC-2020-05/F00023/A01, 30 shtator 2020, Publik ('Shtojca 1').

³ Urdhri për konferencën mbi ecurinë e çështjes, KSC-BC-2020-05/F00023, para.21(b).

⁴ Rregullorja e Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 ('Rregullorja'). Çdo përmendje e termit "rregulla/rregullat" këtu i referohet Rregullores, përveçse kur përcaktohet ndryshe.

gjyqin, ndonëse numri përfundimtar i dëshmitarëve mund të ndryshojë, në varësi edhe të përfundimit të veprimeve të mbetura hetimore.

5. Gjithashtu, ZPS-ja parashikon të paraqesë prova shkresore, duke përfshirë, për shembull, raporte, fotografi dhe dokumente të UÇK-së të asaj kohe të tilla si urdhra, rregullore dhe/ose publikime të tjera. Një përshkrim më i hollësishëm, ndonëse paraprak, i provave që do të paraqiten jepet në pjesët 2 dhe 3 më poshtë.

2. Materiali sipas rregullës 102(1)(a) (Materiali mbështetës i Aktakuzës)

6. Më 29 shtator 2020, ZPS-ja vuri në dispozicion të Mbrojtjes dy paketa të materialit sipas rregullës 102(1)(a). Kjo nxjerrje e parë, që në aspektin e numrit të faqeve përbënte më shumë se gjysmën e të gjithë materialit sipas rregullës 102(1)(a), përfshinte materiale mbështetëse të Aktakuzës që nuk kishin lidhje me dëshmitarët, si dhe të gjitha deklaratat e marra nga i akuzuari.

7. Tabela A jep, për aq sa është e mundur, hollësitë e kërkuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake lidhur me detajimin e këtij materiali⁵ (tashmë të nxjerrë):

Tabela A. Materiali sipas rregullës 102(1)(a) që tashmë i është dhënë të akuzuarit (Paketa 2 dhe 3)

Numri i gjithsejtë i dokumenteve	52
Numri i gjithsejtë i faqeve	1248
Numri i gjithsejtë i orëve/minutave të audio dhe videomaterialeve	Nuk ka të dhëna
Numri i deklaratave të dëshmitarëve	0
Numri i deklaratave të marra nga i akuzuari	2 (që përfshijnë 18 pjesë të transkripteve në anglisht dhe shqip)

⁵ *Shih* Shtojca 1, KSC-BC-2020-05/F00023/A01, para.2, f. 2.

Numri i pjesëve të transkripteve ⁶	18 (transkripte të akuzuarit në anglisht dhe shqip)
Numri i raporteve	4
Numri i audio/videomaterialeve	0
Numri i fotografive	7
Numri i gjësendeve	0
Numri i dokumenteve të tjera ⁷	23

8. Materialet e mbetura mbështetëse të Aktakuzës janë të gjitha të lidhura me dëshmitarët dhe përmbajnë kryesisht deklarata dhe/ose dëshmi. Ky material që ka lidhje me pesë (5) dëshmitarët në të cilët mbështetet ZPS-ja për Aktakuzën e Konfirmuar, do të jetë objekt i kërkesës së parë të ZPS-së për masa mbrojtëse. Kjo kërkesë do të paraqitet brenda dy javësh nga paraqitja e parë e të akuzuarit, sikurse është urdhëruar më herët nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

9. Në përputhje me autorizimin paraprak të përkohshëm të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, materiali mbështetës i Aktakuzës që ka lidhje me dëshmitarët, do të ketë nevojë për redaktimin e informacionit që mund të çojë në identifikimin e dëshmitarëve dhe viktimave, krahas redaktimit të informacionit që përfshihet në kategoritë e identifikuar në parashtrimet e ZPS-së për redaktimet.⁸ Këto redaktime janë në proces drejt përfundimit. ZPS-ja pret që të jetë e gatshme të nxjerrë versionet e redaktuara⁹ të materialit të mbetur mbështetës brenda dy javëve të ardhshme ose,

⁶ Transkriptet e intervistave të ZPS-së janë të ndara në pjesë dhe secila pjesë përfaqëson një dokument të ngarkuar në sistemin elektronik të dokumentacionit gjyqësor.

⁷ Kjo përfshin, për shembull, libra, komunikata apo deklarata politike, raporte, urdhra ushtarakë të UÇK-së,.

⁸ Parashtrime lidhur me sistemin e redaktimit, KSC-BC-2020-05/F00024, 1 tetor 2020 ('Parashtrimet për redaktime').

⁹ Redaktimet e përkohshme të zbatuara, më pas do të rishikohen dhe përshtaten në përputhje me vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake ndaj kërkesës së ardhshme të ZPS-së për masa mbrojtëse dhe mbi sistemin e redaktimeve që duhet zbatuar.

në çdo rast, deri në përfundimin e periudhës prej tridhjetë (30) ditësh të parashikuar nga Rregullorja.¹⁰

10. Përkthimi në shqip i materialit mbështetës të Aktakuzës (duke përfshirë deklaratat dhe transkriptet e dëshmitarëve) praktikisht ka përfunduar dhe edhe këto përkthime do të nxirren brenda afatit 30-ditor të parashikuar për nxjerrjen e materialeve mbështetëse të Aktakuzës.

11. Tabela B paraqet, për aq sa është e mundur, hollësitë e kërkuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake lidhur me gjithë materialin sipas rregullës 102(1)(a), i cili ende nuk është nxjerrë:¹¹

Tabela B. Materiali i mbetur sipas rregullës 102(1)(a) që do të nxirret me redaktime

Numri i gjithsejtë i dokumenteve	52
Numri i gjithsejtë i faqeve	964 (anglisht dhe shqip)
Numri i gjithsejtë i orëve/minutave të audio dhe videomaterialeve	Nuk ka të dhëna
Numri i deklaratave të dëshmitarëve	8 (anglisht dhe shqip)
Numri i deklaratave të marra nga i akuzuari	0
Numri i pjesëve të transkripteve	36 (anglisht dhe shqip)
Numri i raporteve	0
Numri i audio/videomaterialeve	0
Numri i fotografive	0
Numri i gjësendeve	0
Numri i dokumenteve të tjera	8

¹⁰ Rregulla 102(1)(a); Ligji Nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ('Ligji'), neni 39(5). Çdo përmendje e termit 'neni' apo 'nenet' këtu i referohet 'neneve' të Ligjit, përveçse kur përcaktohet ndryshe.

¹¹ *Shih* Shtojca 1, KSC-BC-2020-05/F00023/A01, para.2, ff.2-3.

3. Materiali sipas rregullës 102(1)(b) (Materiali shtesë i destinuar për t'u përdorur në gjykim)

12. Krahas materialit sipas rregullës 102(1)(a), ZPS-ja synon të nxjerrë materiale të tjera sipas rregullës 102(1)(b). ZPS-ja pret të jetë e gatshme të vërë në dispozicion të Mbrojtjes materialet shtesë sipas rregullës 102(1)(b) deri më 1 dhjetor 2020 ose, në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë përpara se Prokurori i Specializuar të hapë çështjen, objekt vetëm i çfarëdo mase mbrojtëse të miratuar.

13. Aktualisht është parashikuar që materiali shtesë sipas rregullës 102(1)(b) të përfshijë deklaratat/dëshmitë e të paktën njëmbëdhjetë (11) dëshmitarëve të tjerë.¹² Transkriptimi dhe përkthimi i deklaratave të këtyre dëshmitarëve po vazhdon në lidhje me tetë (8) dëshmitarë. Ky është një proces i ngjeshur pune që kërkon kohë, kontroll dhe rishikim të kujdesshëm.

14. Për sa u takon provave shkresore, ZPS-ja parashikon që të paraqesë afërsisht pesëdhjetë (50) prova materiale në gjyq. Ky vlerësim paraprak mund të ndryshojë në varësi të, ndër të tjera, rëndësisë së provave të siguruara kohët e fundit dhe të rezultateve të veprimeve të mëtejshme të kufizuara hetimore. Ka të ngjarë, që provat materiale të përfshijnë materiale të dhëna nga dëshmitarët gjatë intervistave, fotografi, raporte, dokumente bashkëkohëse dhe videomateriale.

15. Do të jetë e nevojshme që materialet sipas rregullës 102(1)(b) që kanë lidhje me dëshmitarët të redaktohen në pjesët që identifikojnë viktimat dhe dëshmitarët, në përputhje me autorizimin paraprak të përkohshëm të Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe/ose çdo masë mbrojtëse që mund të miratohet, krahas redaktimit të informacionit që përfshihet në kategoritë e identifikuar në parashtrimet e të ZPS-së për redaktimet. Në këtë drejtim, ZPS-ja synon të dorëzojë një kërkesë të dytë për masa

¹² *Shih* para.4 më sipër. Numri përfundimtar i dëshmitarëve (duke përfshirë vendimin nëse duhet të thirren dëshmitarë ekspertë për të dëshmuar) do të varet nga rezultatet e veprimeve të kufizuara hetimore të mbetura.

mbrojtëse lidhur me tetë (8) prej dëshmitarëve shtesë. ZPS-ja parashikon që të jetë në gjendje të dorëzojë këtë kërkesë të dytë për masa mbrojtëse menjëherë pasi kërkesa e parë për masa mbrojtëse e ZPS-së të jetë diskutuar e shqyrtuar dhe të jetë marrë një vendim për të.

4. Materiali sipas rregullës 102(3) (Materiale provash për përgatitjen e Mbrojtjes dhe materiale të marra nga i akuzuari apo që i përkasin të akuzuarit)

16. ZPS-ja parashikon që, deri më 1 dhjetor 2020, t'i japë Mbrojtjes një njoftim të hollësishëm për materialet e provave, në përputhje me nenin 21(6) dhe rregullën 102(3), pas përfundimit të përcaktimit të materialeve dhe nxjerrjes së materialit sipas rregullës 102(1)(b). Dokumentet e përmendura në njoftimin sipas rregullës 102(3) do të përfshijnë çdo informacion tjetër të mbetur që mund të jetë juridikisht thelbësor për Mbrojtjen, pasi materialet që do të paraqiten në gjykim¹³ dhe materialet potencialisht shfajësuese¹⁴ të jenë bërë të njohura.¹⁵

17. ZPS-ja pret që një pjesë e materialit sipas rregullës 102(3) të ketë nevojë për redaktime, në veçanti materiali sipas rregullës 108(1).

5. Materiali sipas rregullës 103 (Provat shfajësuese)

18. Më 29 shtator 2020, ZPS-ja vuri në dispozicion të Mbrojtjes paketën e parë të materialit potencialisht shfajësues. Redaktimet e vetme që iu bënë (përkohësisht) këtij

¹³ Rregulla 102(1)(b).

¹⁴ Rregulla 103.

¹⁵ Fushëveprimi i materialit sipas rregullës 102(3) domosdoshmërisht ndikohet dhe varet në një masë të madhe nga dëshmitarët dhe provat që synohet të paraqiten në gjyq. Rrjedhimisht, nuk është e mundur të jepet një vlerësim i saktë në këtë kohë. Pavarësisht nga kjo, bazuar në rishikimin vijues, ZPS-ja parashikon që numri i dokumenteve sipas rregullës 102(3) të jetë dukshëm më pak se 1000 në total.

materiali ishin redaktimet lidhur me të dhënat e kontaktit dhe për mbrojtjen e emrave të hetuesve.¹⁶

19. Tabela C paraqet, për aq sa është e mundur, hollësitë e kërkuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake lidhur me materialin sipas rregullës 103, që u nxor për Mbrojtjen më 29 shtator 2020.¹⁷

Tabela C. Materiali sipas rregullës 103 i nxjerrë për të akuzuarin (Paketa 4)

Numri i gjithsejtë i dokumenteve	61
Numri i gjithsejtë i faqeve	613
Numri i gjithsejtë i orëve/minutave të audio dhe videomaterialeve	Nuk ka të dhëna
Numri i deklaratave të dëshmitarëve	3
Numri i deklaratave të marra nga i akuzuari	0
Numri i transkripteve	11
Numri i raporteve	0
Numri i audio/videomaterialeve	0
Numri i fotografive	0
Numri i gjësendeve	0
Numri i dokumenteve të tjera	47

20. Aktualisht, ZPS-ja po shqyrton një paketë të dytë të materialit potencialisht shfajësues. Kjo paketë ka të ngjarë të kërkojë edhe disa redaktime, në veçanti në

¹⁶ Këto redaktime janë zbatuar përkohësisht në mënyrë që të lehtësohej nxjerrja e menjëhershme. Redaktimet që iu bënë materialit ishin në përputhje me kategoritë e redaktimeve të propozuara në parashtrimet për redaktime. Redaktimet do të rishikohen, nëse është e nevojshme, pas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për sistemin e redaktimit që duhet zbatuar në këtë çështje.

¹⁷ *Shih* Shtojca 1, KSC-BC-2020-05/F00023/A01, para.5, f.4.

përputhje me rregullën 108(1). Çdo material potencialisht shfajësues i identifikuar në atë paketë do të nxirret menjëherë pas shqyrtimit dhe redaktimit.

21. ZPS-ja do të vijojë të shqyrtojë dhe, pas zbatimit të redaktimeve të nevojshme, do të nxjerrë menjëherë hap pas hapi çdo material sipas rregullës 103 që ka në ruajtje, nën kontroll apo në dijeninë e vet faktike.

6. Materiali sipas rregullës 107 (Materiali i mbrojtur)

22. Tashmë janë siguruar të gjitha miratimet përkatëse sipas rregullës 107 lidhur me materialin që ZPS-ja aktualisht parashikon ta paraqesë si provë në gjykimin e kësaj çështjeje. Miratime të tilla janë siguruar edhe për të gjithë materialin i cili është identifikuar deri më tani se përfshihet në materialin e përcaktuar sipas rregullës 102(3) ose rregullës 103.

23. ZPS-ja do të njoftojë pa vonesë Gjykatësin e Procedurës Paraprake nëse identifikohet ndonjë material tjetër me rëndësi për çështjen që është objekt i kufizimeve të rregullës 107.

7. Informacioni që do të jepet nga ZPS-ja dhe nga Zyra për Mbrojtje dhe Mbështetje të Dëshmitarëve ('ZMMD')

24. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

25. ZPS-ja parashikon që masat mbrojtëse në sallën e gjyqit do të jenë të nevojshme për disa prej dëshmitarëve shtesë, të dëshmitë e të cilëve do të mbështetet gjykimi dhe parashikon të dorëzojë një kërkesë për masa mbrojtëse në lidhje me ta.¹⁸ Informacioni

¹⁸ *Shih* para.15 më sipër.

përkatës në lidhje me dëshmitarët e mbetur do t'i bëhet menjëherë i ditur ZMMD-së për të ndihmuar në vlerësimet përkatëse të rrezikut.

26. Ky parashtrim protokollohet si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* sepse përmban informacion në lidhje me sigurinë e dëshmitarëve. Njëkohësisht po dorëzohet edhe një version i redaktuar publik.

Numri i fjalëve (në origjinal): 1917

_____/nënshkrimi/_____

Xhek Smith
Prokuror i Specializuar

E hënë, 5 tetor 2020
Në Hagë, Holandë